

**Ilirjana KACELI (Demirlika)<sup>1</sup>**

## **THE TREATY OF LAUSANNE AND ITS IMPACT ON ALBANIAN-TURKISH RELATIONS**

### **Abstract**

The Lausanne Conference started operating on November 21, 1922. A basic stance that the Ankara government upheld throughout the meeting was that Turkey should be treated as an independent, sovereign nation on par with the other participating governments. Its reputation in the worldwide community was formed as a result of this attitude. Turkey absolutely did not flinch in the face of any proposal that would have an impact on Turkish sovereignty when discussing matters relating to financial control, minorities' protection, capitulations, straits, etc. The Greco-Turkish agreement on the exchange of populations was signed in January 1923, and the Treaty of Lausanne was signed on July 23, 1923, under the watchful eyes of the Great Powers and the League of Nations. The people exchange agreement was a tool that indirectly impacted Albania because it jeopardized the livelihood of the Albanian minority in Greece. Because of this, the Albanian government made an extra effort to respond in the international arena and realize the rescue of this community in order to avoid becoming a victim of the exchange. The Albanian administration sought negotiations with the Turkish government because it was unable to reach an understanding with the Greek government regarding cooperation. When this pressure was applied, Turkish diplomacy had just recently reaffirmed Albania's position. Turkey, on the other hand, opposed including the Chameria people in this exchange. As a result, it shifted its political stance by permitting and making the establishment of the criteria for the modified population a requirement. The articles from the 1920s and 1930s press as well as archive documentation sources from the era served as the foundation for this essay.

---

<sup>1</sup> Prof. Assoc. Dr. Ilirjana KACELI (Demirlika)  
Kolegji Universitar "Beder";  
ikaceli@beder.edu.al;

**Keywords:** *Treaty of Lausanne, Turkey, exchange agreement, minority, criteria*

## **TRAKTATI I LOZANËS DHE NDIKIMI I TIJ NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-TURKE**

### **Abstrakt**

Më 21 nëntor të vitit 1922 nisi punimet Konferenca e Lozanës. Në këtë konferencë qeveria e Ankarasë mbajti një qëndrimin themelor, se Turqia duhej trajtuar si një vend i pavarur e sovran, i barabartë me të gjithë shtetet pjesëmarrëse. Nëpërmjet këtij qëndrimi u vendos prestigji i saj në arenën ndërkombëtare. Në diskutimin e çështjeve që lidheshin me kontrollin e financave, mbrojtjen e pakicave, kapitullimet, ngushticat etj, Turqia, në mënyrë absolute nuk u lëkund përballë çdo propozimi që mund të prekte sovranitetin turk. Nën monitorimin e Fuqive të Mëdha dhe të Lidhjes së Kombeve, në janar të vitit 1923 u nënshkrua edhe marrëveshja greko-turke për shkëmbimin e popullsisë dhe pas diskutimesh të gjata, më 23 korrik 1923 u nënshkrua Traktati i Lozanës. Marrëveshje e shkëmbimit të popullsisë ishte një instrument që prekte tërthorazi edhe Shqipërinë, sepse nëpërmjet tij, do të cënohej ekzistenca e minoritetit shqiptar në Greqi. Ndaj ky fakt shtoi përpjekjet e qeverisë shqiptare të reagoje në arenën ndërkombëtare, për të realizuar shpëtimin e kësaj popullsie, në mënyrë që të mos bëhej pre e shkëmbimit. Duke qenë se qeveria shqiptare nuk mundi të gjente një gjuhë bashkëpunimi me qeverinë greke, iu drejtua bisedimeve me qeverinë Turke. Ky presion u bë në një kohë kur qëndrimi i Shqipërisë sapo ishte afirmuar në diplomacinë turke. Turqia nga ana e saj nuk ishte për përfshirjen e popullsisë së Çamërisë në këtë shkëmbim, ndaj e ndryshoi kursin e saj politik duke toleruar dhe duke vënë si kusht përcaktimin dhe zbatimin e kriterëve për popullsinë e ndryshuar. Ky punim bazohet mbi burime dokumentare arkivore të kohës si edhe mbi artikujt të shkruar në shtypin e viteve 1920-1930.

**Fjalë kyçe:** *Traktati i Lozanës, Turqia, marrëveshja e shkëmbimit, minoritet, kriterë;*

## **HYRJE**

Përfundimin i Luftës Turko-Greke me fitoren e Turqisë, i hapi rrugë një sfide të re, vendosjes së prestigjit të shtetit të ri nacionalist turk në arenën ndërkombëtare. Pas Luftës Greko-Turke, do fillonte kriza e refugjatëve. Në betejën e Sakarjas (23 Gusht - 13 Shtator 1922) ushtria greke humbi, ky ishte shkak që e detyroi tërheqjen e saj nga fronti i luftës. Bashkë me ë edhe qindra mijëra banorw civilë të besimit ortodoks të krishterë nuk e ndjenin veten të sigurt ndaj e shoqëruan ushtrinë greke në tërheqjen e saj drejt Greqisë. Ardhja masive e refugjatëve civilë në Greqi krijoi një anarki dhe ngarkesë të madhe për qeverinë. Prandaj kryeministri grek iu drejtua Lidhjes së Kombeve më 16 Tetor 1922 me kërkesën për “*këmbim të detyrueshëm të popullsive turke e greke*”, duke kërkuar prej Komisarit për refugjatë Fridtjof Nansen që të vepronte sa më shpejt. Emigrimi i banorëve nga zonat që ishte zhvilluar lufta ishte një proces i gjatë, ndaj fenomeni i shkëmbimit të popullsisë u konsiderua nga aktorët politikë të kohës, si një nevojë emergjente për të parandaluar katastrofat që mund të shfaqeshin. Prandaj u pa e arsyeshme që të arrihej një marrëveshje zyrtare midis Turqisë dhe Greqisë, e cila ndryshe nga marrëveshja e vitit 1914, që kishte karakter dypalësh, tanimë po vendosej me dakordësinë e aktorëve ndërkombëtarë të kohës, nën sfondin e Lidhjes së Kombeve.

Konferenca e Lozanës, i zhvilloi punimet nga 21 nëntori i vitit 1922 deri më 23 korrik 1923. Në qendër të punimeve ishte vendosja e paqes midis Turqisë nga njëra anë dhe Greqisë e shteteve të Antantës nga ana tjetër. Konferenca ishte e ndarë në disa sesione, në të cilat u diskutuan çështje të rëndësishme që ishin në interes dhe në funksion të vendosjes së paqes, si: shkëmbimi dhe shpërngulja e popullsisë, çështja e borxheve publike otomane, kapitulacionet etj.

Drejtues i Konferencës u zgjodh përfaqësuesi britanik Lordi Kurzon. i cili deklaronte se baza e diskutimit do të ishte Traktati i Sevres, të cilit mendohesh ti bëhej ndonjë ndryshim<sup>2</sup>. Traktati i Sevres për përfaqësuesit nacionalist turq ishte i papranueshëm ndaj nuk mendonin të diskutonin në bazë të këtyre kushteve. Asambleja e Madhe Turke i kishte dhënë delegacionit udhëzime për tu shprehur dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre, të cilat bazoheshin në Paktin Kombëtar (Misaki-Milli)<sup>3</sup>.

Përfaqësuesit e nacionalistëve turq gjatë punimeve të Konferencës mbajtën qëndrimin e tyre duke kërkuar që Turqia të trajtohej si një komb i pavarur dhe sovran në të njëjtin nivel me qeveritë e tjera pjesëmarrëse. Reputacioni i saj në komunitetin mbarëbotëror u vendos si rezultat i këtij qëndrimi. Turqia absolutisht nuk u zbraps përballë asnjë propozimi që do të kishte ndikim në sovranitetin turk kur diskutohej për çështje që kanë të bëjnë me kontrollin financiar, mbrojtjen e pakicave, kapitulacionet, ngushticat, etj.

Për Shqipërinë, çështjet që preknin direkt interesat e saj ishin marrëveshja e shkëmbimit të popullsisë dhe çështja e borxhit publik otoman. Më 23 Korrik 1923, në fund të punimeve, midis

<sup>2</sup> *Başbakanlık Cumhuriyet Arşivine* (më tej- B.C.A), Fon Kodu, 301000, Kutu no.218, Sıra no.26, dosya gömleği no.472.

<sup>3</sup> *Türk İstiklal Harbi*, (TIH), C.2, Kitap 4, Genel Kurmay ATASE Yay.: Ankara, s.117-118: *Atatürk ve Türkiye Cumhuriyeti Tarihi*, Besinci Baskı, Siyasal Kitabevi, vitin f.221

Turqisë dhe Greqisë u nënshkrua edhe një traktat që ka hyrë në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare me emrin Traktati i Lozanës.

Për palën Turke nënshkrimi i këtij traktati në të vërtetë, ishte fitore e re për Qeverinë e Ankarasë me në krye Mustafa Kemal, sepse nëpërmjet tij u hodhën poshtë vendimet e poshtëruese të Traktatit të Sevres (1 Gusht 1920), rifituan prestigjin dhe njohjen e ndërkombëtare duke e kthyer vendin e tyre në një shtet të madh dhe të fuqishëm me kufijtë të cilët ekzistojnë edhe sot. Më 29 Tetor 1923, kjo fitore u kurorëzua me shpalljen e Republikës së re Turke që hodhi bazat e Turqisë moderne. Ndërsa për palën greke nënshkrimi i traktatit i dha fund ëndrrës së saj për krijimin e Greqisë së Madhe në ishujt e Egjeut, ku dikur kishte ekzistuar Perandoria Bizantine. Tashmë Greqia do të orientonte synimet e veta në drejtim të trojeve shqiptare të krahinës së Çamërisë, Janinës, Follorinës dhe Maqedonisë veriore.

#### **a. Marrëveshja greko-turke dhe rrjedhojat për popullsinë shqiptare të Çamërisë**

Më 2 dhjetor 1922, sipas dokumentave arkivore,<sup>4</sup> qeveria shqiptare vendosi të dërgojë si përfaqësues zyrtar në konferencën e Lozanës Mehdi Frashërin<sup>5</sup>. Qeveria shqiptare ishte e bindur se, çështja e shqiptarëve në Greqi duhej ngritur me forcë në Konferencën e Lozanës, ndaj do të udhëzonte delegacionin shqiptar që të bënte të gjitha përpjekjet për mbrojtjen e minoritetit shqiptar në Greqi<sup>6</sup>.

Ndërkohë që në Lozanë vazhdonin bisedimet, persekutimet e qeverisë Greke ndaj popullsisë shqiptare të Çamërisë vazhdonin.

Më 18 dhjetor 1922 në Këshillin Kombëtar (parlament), nga qeveria shqiptare u thirr një seancë e veçantë në lidhje me ngjarjet në Çamëri. Deputetë të ndryshëm të parlamentit shqiptar nëpërmjet diskutimeve kërkuan zbatimin dhe sigurimin e të drejtave civile të kësaj popullsie, po aq dhe i të drejtave që i takonin si pakicë<sup>7</sup>.

Delegacionet greke dhe turke në Lozanë, në periudhën e parë të Konferencës, bënë një projekt *ad hoc*, ku u dakortësua për këmbimin e popullatës së Maqedonisë, të Epirit e të Azisë së Vogël. Pas kësaj, qeveria e Athinës nxori disa ligje të posaçme, ku cënonte gjerësisht të drejtat e pasurisë së atyre familjeve, që do të pësonin fatkeqësinë e zbatimit të marrëveshjes<sup>8</sup>. Kjo kishte lidhje me artikullin 14 të marrëveshjes përcaktonte që vlera e pronës së qytetarit të njërit vend që ishte shpërngulur përbënte borxh shtetëror për shtetin tjetër. Kështu që, shumica e shqiptarëve ishin të detyruar të shkonin në Turqi për të rifituar vlerën e humbur nga prona e tyre.

Qeveria shqiptare, duke ndjerë rrezikun që vinte nga Traktati i Lozanës, duke parë tendencën e qeverisë greke për të shkëmbyer popullsinë shqiptare çame me atë ortodokse të Turqisë, nxitoi të

<sup>4</sup> AMPJ, F.151, Dos.103, V.1922, f.17. Teleg, chiffré de Geneve date 22 Novembre 1922, nr.02859. Heure 19.15 Ministre Affaires Etrangères Tiranë. Revecua Tiranë 23 Novembre.

<sup>5</sup> AMPJ, F.151, Dos.103, v.1922, f.17. Teleg, chiffré de Geneve date 22 Novembre 1922, nr.02859. Heure 19.15 Ministre Affaires Etrangères Tiranë. Revecua Tiranë de 23 Novembre.

<sup>6</sup> Gazeta "Shqipëria e re" (Novia Albania), 7 janar no.112, f.1: Fatmira Rama, *Problemi Çam në Lidhjen e Kombeve (1923-1926)*, në: Studime Historike, nr.1-2, Tiranë: 2007, f.112.

<sup>7</sup> Fatmira Rama, *Traktati i Lozanës, shpërnguljet dhe shpronësimi (1923-1926)*, në "Çështja Çame dhe Integrimi Evropian", Instituti i Studimeve për Çamërinë, Fakultetit i Histori-Filologjisë, Arbëria, Tiranë: 2005, f.42.

<sup>8</sup> Hajredin Isufit, *Çamëria ndërmjet kronikave të kohës 1902-1940*, Pegi, Tiranë: 2007, f.281.

sigurohej se minoriteti Çam në Greqi nuk do të ishte pjesë e kësaj marrëveshjeje. Më 11 janar të vitit 1923, përfaqësuesi i qeverisë shqiptare pranë Konferencës së Lozanës, Mehdi Frashëri i kërkoi kryetarit të Seksionit të Pakicave në Lozanë, që të merrte të gjitha masat dhe të bënte demarshet e duhura pranë qeverive greke e turke, që popullsia myslimane shqiptare e Çamërisë dhe krejt krahinave të banuara nga shqiptarë të mos ishte objekt shkëmbimi<sup>9</sup>.

Përfaqësuesi i Shqipërisë paraqiti edhe një histori të shkurtër mbi popullsinë Çame në Greqi, duke argumentuar se, “*banorët e kësaj krahine çamët banonin në Greqi qysh prej kohërave që s’mbahen mend, edhe përpara se të zbrisnin grekët në Evropë*”<sup>10</sup>.

Më tej, përfaqësuesi Montagna, e parashtrroi këtë çështje në Konferencën e Lozanës, dhe kërkoi që shqiptarët të mos shkëmbeheshin<sup>11</sup>.

Përfaqësuesi grek Caclamanos, u detyrua të pranonte faktin se Greqia nuk kishte si qëllim të kryente shkëmbimin e myslimanëve me prejardhje shqiptare dhe se shqiptarët banonin në një rajon të përcaktuar qartë, që quhet Epir<sup>12</sup>. Sipas tij, shqiptarët banojnë në një truall etnik të përcaktuar qartë dhe fakti që ata kanë të njëjtin besim fetar me turqit, nuk do të thotë se janë bashkëatdhetarë me ta<sup>13</sup>.

Krahas tij, edhe delegate turk, Riza Nuri Beu, gjithashtu do të deklaronte që “*shqiptarët të mos përfshiheshin në shkëmbim*”. Komisioni do ta mbyllte raportin e tij duke vendosur që, “*shqiptarët nuk do të ishin pre e shkëmbimit*”<sup>14</sup>.

Ndërkaq kryetari i sesionit të pakicave në Konferencën e Lozanës, Gulio Cesare Montagna më 20 janar 1923 e njoftonte Mehdi Frashërin, mbi deklaratën, që delegatët turq ashtu si edhe përfaqësuesit grekë kishin bërë. Ai pohonte se pakicat shqiptare të Turqisë dhe të Greqisë, ishin ligjërisht dhe faktikisht të përjashtuara nga shkëmbimi i popullsisë<sup>15</sup>.

Përjashtimi i shqiptarëve nga shkëmbimi i arritur në këtë marrëveshje do të pasqyrohej edhe në dokumentat e arkivës turke, duke vërtetuar fjalët e diskutuara në sesionin e Lidhjes<sup>16</sup>. Sipas Mehdi Frashërit “*kjo i shpëtoi çamët nga shkëmbimi i detyruar*”<sup>17</sup>.

Për qeverinë turke e greke, ajo ishte çështje e shkëmbimit të pakicave, por për popullin shqiptar në mënyrën se si u realizua, do të rezultonte një shpërngulje masive e shqiptarëve myslimane nga Çamëria.

<sup>9</sup>AQSH, Fondi 251, viti 1923, dos. 203, fl. 6: Letër e Mehdi Frashërit si, i deleguar i Shqipërisë pranë Konferencës së Lozanës, drejtuar Z. Montagna, kryetar i Komisionit të Pakicave, Lozanë, 11 janar 1923.

<sup>10</sup> Hajredin Isufi, *Politika e shtetit grek për dëbimin e popullsisë Çame*, Studime Historike, nr. 1-4, Tiranë: 1993, f.64.

<sup>11</sup> Dhimitër Berati, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*, Tiranë: Husi Borshi, 2007, f.43.

<sup>12</sup> AQSH, Fondi 251, viti 1923, dos. 203, fl.100. Telegram i Benoit Blinishti, konsull i Përgjithshëm i Shqipërisë në Gjenevë, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, Tiranë.

<sup>13</sup> Beqir Meta, *Tragjedia Çame*, Instituti i Studimeve për Çamërinë, Botimet Klean, Tiranë: 2010, f.35. Oëen Pearson, *Albania and King Zog (Independence, Republic and Monarchy 1908-1939)*, The centre for Albanian Studies, London: 2004, f.202.

<sup>14</sup> *Ethnic Minorities in the Balkan States 1860-1971*, vol. 4. (1923-1926), (Editor B.Destani), Published Archives, London: 2008, f.338.

<sup>15</sup> AQSH, F.151, V.1923, D.203, fl.14. Kryetari i Seksionit të Pakicave në Konferencën e Lozanës, i drejtohet Mehdi Frashërit, i deleguar i Shqipërisë pranë kësaj Konference.

<sup>16</sup> B.C.A, Fon Kodu.2720011, Kutu16, Dosya Gomlegi, 68.

<sup>17</sup> Mehdi Frashëri, *Kujtime (Vitet 1913-1933)*, Tiranë: OMSCA-1, 2005, f.157.

Sipas studiuesve turq, më 9 shtator 1922 filloi shpërngulja e grekëve nga Izmiri duke larguar me detyrim 300.000 Rum (grekë) brenda një muaji, dhe pas marrëveshjes së Mudanias edhe 60.000 persona të tjerë nga zona e Trakisë dhe e Stambollit<sup>18</sup>.

Në vitin 1923, pozita e rreth 20 000 shqiptarëve muslimanë që mbetën në Greqinë veriore, do të bëhej objekt debatesh dhe diskutimi në një sesion special të Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Doktor Nansen, i ngarkuar nga Lidhja e Kombeve paraqiti para saj një raport të saktë mbi krahinat dhe popullsinë që do të shkëmbeheshin. Pavarësisht diskutimeve që u zhvilluan u vendos që shkëmbimi i popullsisë të realizohej, jo vetëm me dëshirë dhe paqësisht, por në rast se kishte kundërshtime edhe pa dëshirën e tyre,<sup>19</sup>.

Më 30 janar 1923 u nënshkrua një konventë e njohur si “*Konventa Greko-Turke për shkëmbimin dhe shpërnguljen e popullsisë*”. Konventa u nënshkrua në Konferencën së Lozanës si një marrëveshje e veçantë ndërmjet Greqisë dhe Turqisë. Sipas kësaj marrëveshjeje midis të dyja vendeve do të bëhej shkëmbimi i popullsisë, saktësisht do të shkëmbeheshin “*greqët (rumët)*” e Anadollit, me “*turqit*” e Greqisë<sup>20</sup>.

Në marrëveshje në artikullin e parë ishte përcaktuar se: “Qysh nga 15 maji i vitit 1923: do të kryhej shkëmbimi i detyrueshëm i qytetarëve turq të fesë ortodokse greke të vendosur në territorin turk me qytetarët grekë me fe myslimane të vendosur në tokat greke”<sup>21</sup>. Këta persona nuk do të mund të riktheheshin për të jetuar në Turqi apo në Greqi, pa autorizimin respektiv të qeverisë turke e greke. Në këtë shkëmbim nuk do të përfshiheshin “*banorët grekë të Stambollit dhe turqit e Thrakës Perëndimore*”.

Të shkëmbyerit mund të merrnin me vete plaçka, por edhe mallra, në doganë do t’u vendosej taksa përkatëse. Vetëm për personelin e xhamive, teqeve, medreseve, kishave, shkollave, spitaleve, vakifeve mund të lejohej të transportonin plaçkat e tyre pa paguar asnjë lloj takse. Të shkëmbyerit duhet të linin vendin e origjinës dhe të fitonin nënshtetësinë e vendit ku shkonin pa të drejtë kthimi. Ata duhet të plotësonin një formular, ku si detyrim kryesor ishte deklarimi mbi pronat që zotëronin, pasuritë e patundshme dhe vlefën e tyre<sup>22</sup>.

Kjo marrëveshje u shfrytëzua nga pala greke për të bërë realitet dëbimin pa të drejtë të shqiptarëve me banim në Greqi<sup>23</sup>. Qeveria greke, pa humbur kohë filloi nga puna për vënien në zbatim të marrëveshjes si dhe të politikave të saj ç’kombëtarizuese ndaj minoritetit çam në dyja rajonet Çamëri dhe krejt Epirin. Në këtë kuadër u ngritën disa zyra të veçanta, që do të merreshin me trajtimin e çështjes së dokumenteve dhe atë të sistemimit të refugjatëve, si Drejtorja për Vërtetimin

<sup>18</sup> Y.H.Aganoğlu, *Osmanlı'dan Cumhuriyete Balkanların Makus Talihi: Goç*, İz Yayincılık, 7 Baskı, İstanbul: 2012, f.307: Hakki Akalin, “*Ege'de Bahar, Gül mü Diken Mi!*”, Umit Yayincılık, Ankara: 2000, f.91.

<sup>19</sup> Mumtaz Peker, *Lozan Konferansın'da Nüfus Tartışmaları*, Belleten Cilt LXIX, Sayı 256, Ankara: 2005, s.1021.

<sup>20</sup> Në historiografinë turke njihet me këtë emër “*Yunan ve Türk Halklarının Mübadelesine İlişkin Sözleşme ve Protokol*”. Başbakanlık Cumhuriyet Arşivi, 272.00.12/40.40.3; Kemal Ari, *Büyük Mübadele, Türkiye Zorunlu Göç (1923-1925)*, İstanbul: 1995, f.8-9.

<sup>21</sup> Hasan Minga, *Marrëveshja e Lozanës*, nënshkruar më 30.01.1923, Artikulli i I, paragrafi i parë. shih, “Çamëria” Nr. 7 (26), Viti II- të, 8 maj 1992, f.3-4.

<sup>22</sup> E. Çelebi, *Mübadellere Yunanistan'daki Mal Kazıları ve Muhtelit Mübadele Komisyonu Tasfize talepnameleleri*, ÇITTAD, V/12, (2006/ Bahar), s.35-36.

<sup>23</sup> *Convention Concerning the Exchange of Greek and Turkish Populations*, Treaty series 32, v.1925,

f. 77-87: *Fletorja Zyrtare*, 9 shtator 1923: Hajredin Isufi, *Çamëria, studime historike-sociologjike Shek. XIII-XX*, Pegi, Tiranë: 2006, f.115.

e Kombësisë dhe Zyra Autonome e Stabilizimit të Refugjatëve, që do të funksiononte pranë Ministrisë së Jashtme greke<sup>24</sup>.

Autoritetet greke kishin hartuar lista me emrat e banorëve çamë që kishin pranuar “me dëshirë” të largoheshin drejt Turqisë. Brenda 4 muajve të vitit 1923, ishin përgatitur lista me 5 000-10 000 shqiptarë si të shkëmbyeshëm. Për hartimin e këtyre listave dhe përfshirjen e çamëve, kryesisht të Paramithisë, banorët fajësonin myftiun e atij qyteti, i cili i shtyrë nga presioni i autoriteteve greke, apo dhe i paguar, detyronte çamët myslimanë të regjistroheshin si turq<sup>25</sup>.

Lidhja e Kombeve për të mbikqyrur procesin e shkëmbimit të popullsisë kishte krijuar një komision të posaçëm, të quajtur komisioni *Mikst*, ku në përbërje të tij do të kishte përfaqësues nga të dyja palët dhe do të drejtohej nga një përfaqësues i huaj<sup>26</sup>. Më 5 shtator 1923, për herë të parë kryeministri turk Fethi Okyarit në mbledhjen e qeverisë turke, diskutoi për çështjen e zhvillimit të shkëmbimit të popullsisë si dhe propozoi krijimin e një ministrie për këtë çështje.<sup>27</sup>

Krahas qeverisë diskutimet u zhvilluan edhe në e Asamblesë së Madhe Turke rreth problemit të shkëmbimit të popullsisë. Deputeti i Sinopit, Riza Nuri Beu deklaronte se, “*shqiptarët këmbëngulin të vendosen përreth Izmirit dhe Stambollit dhe jo në zonat e largëta*”<sup>28</sup>. Pas diskutimeve dhe debateve të zhvilluara u pranua se duheshin hartuar strategji si dhe të hartoheshin planet për vendosjen dhe strehimin e refugjatëve të ardhur në Turqi. Më 13 tetor 1923, u themelua në Ankara, *Ministria e Shkëmbimit, Strehimit dhe Rindërtimit*. Dy ditë më vonë Asambleja e Madhe Turke, me 158 vota pro zgjodhi Mustafa Nexhatin, si ministrin e parë të saj<sup>29</sup>. Mbi këtë bazë qeveria Turke kishte hartuar një plan dhe të ardhurit u sistemuan në 10 zona<sup>30</sup>, që shtriheshin në krahinën e Detit të Zi, Detit Marmara, Detit Egje, në zonën e Anadollit dhe zonën e Detit Mesdhe. Në nëntor të vitit 1923, ish deputeti çam i Prevezës, Ali Dino, në emër të shqiptarëve të Çamërisë i shkruante kryetarit të Komisionit Mikst për këmbimin e popullsisë greko-turke seçamët pavarësisht përkatësisë fetare me turqit, nuk duhet të bëhen viktima të kësaj marrëveshje<sup>31</sup>.

Madje, popullsia çame kishte kërkuar dhe mbështetjen e qeverisë shqiptare të Tiranës që të studionte mundësinë e krijimit të një organizate çame për të komunikuar drejtpërdrejtë me Lidhjen e Kombeve dhe Konferencën e Lozanës për çdo shkelje të pikave të Traktatit të Lozanës në lidhje

<sup>24</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, (periudha e pavarësisë 28 nëntor 1912-7 prill 1939), Tiranë: Botimet “Toena”, f.502.

<sup>25</sup> *AQSH*, F.151, V.1923, D.203, fl.38. Njoftim I Pandeli Evangjelit, ministër I Punëve të Jashtme të Shqipërisë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Tiranë 15 maj 1923.

<sup>26</sup> Sipas varianti turk *Komisioni i Mikst i Shkëmbimit*, njihet si: *Muhtelit Mübadele Komisyonu* ose *Karma Komisyonu. Mübadele Sözleşmesi*, Md.11, *Başbakanlık Cumhuriyet Arşivi*, 272.00.12/40/40.3.

<sup>27</sup> *Açıksöz*, 3 Ekim 1923.

<sup>28</sup> *TBMMZC.*, C.9, s.107-108.

<sup>29</sup> Ky ministër solli 140.000 refugjatë në Turqi, brenda një periudhe 6 mujore. Për më tepër shih: Kemal, Ari, *Büyük Mübadele, Türkiye'ye Zorunlu Göç (1923-1925)*, İstanbul: 1995, f.22-28.

<sup>30</sup> Kemal Ari, *Buyuk Mübadele, Türkiye'ye Zorunlu Göç* s.8-9. H.Yildirimi Ağanoğlu, *Balkanların Makus Talihi Göç (Osmanlı'dan Cumhuriyete)*, İz Yayıncılık, İstanbul: 2012, f.317; shih.H.Öksüz, *Balkan Ülkelerinden Türkiye'ye göç sonrası iskan meselesi (1923-1938)*, VII, Milletler Arası, Turkoloji Kongresi, İstanbul: 1999, f.173. 1

<sup>31</sup> *AQSH*, F.151, V.1923, D.203, fl.398-399. Letër e Ali Dinot, ish deputet i Prevezës në Athinë, drejtuar gjeneral De Larës, kryetar i Komisionit Mikst për këmbimin e popullsisë greko-turke, Athinë, 24 nëntor 1923

me pakicat. Një kërkesë e tillë iu parashtrua qeverisë shqiptare të kryesuar nga Ahmet Zogu në verën vitit 1923 prej konsullit të përgjithshëm shqiptar në Zvicër, Benoi Blinishti<sup>32</sup>.

Në bazë të këtyre kërkesave, autorizohej Ministria e Punëve të Jashtme për veprime diplomatike në këtë drejtim. Duke qenë se procesi i shkëmbimit të popullsisë ndërmjet Greqisë dhe Turqisë ishte në zhvillim e sipër, autorizohej dërgata shqiptare në Ankara, që të merrte masa serioze pranë qeverisë turke, që të ndihmonte popullsinë në shpëtimin e popullsisë së Çamërisë<sup>33</sup>.

Megjithatë, pavarësisht dëshirës dhe presionit të qeverisë shqiptare në këtë periudhë ishte e vështirë që të kërkohej refuzimi i shkëmbimit të popullsisë nga qeveria turke, sepse ende midis dy shteteve nuk ishin vendosur lidhjet diplomatike.

Qeveria shqiptare vazhdonte të ishte e shqetësuar për shkëmbimin e shqiptarëve të Çamërisë ndaj u detyrua ta shtronte çështjen në seancën e Këshillit të Lidhjes së Kombeve në dhjetor 1923. Midis përfaqësuesit shqiptar dhe atij grek në këtë seancë pati debate. Këmbëngulja e diplomatit shqiptar në Këshillin e Lidhjes Kombeve, e detyroi, komisionin Mikst të pranonte, shtyrjen dhe nisjen e çdo personi që paraqiste një pretendim të mirëfilltë për prejardhjen shqiptare dhe për të hetuar çështjen u krijuan nënkomisione me përfaqësues grekë, turq dhe një person asnjans<sup>34</sup>.

Gjatë vitit 1923, Greqia arriti një pjesë të synimit të saj për spastrimin etnik të shqiptarëve arriti të dëbojë shumicën e shqiptarëve të provincës së Maqedonisë.

## **2. Ndikimi i Traktatit në marrëdhëniet shqiptaro-turke**

Nga fillimi i vitit 1924, Komisionit Mikst do t'i shkonin informacione për grabitje të pasurisë së çamëve, arrestimin dhe keqtrajtimin e tyre nga xhandarmëria greke si dhe vendosjen në pronat e tyre të refugjatëve të ardhur nga Turqia<sup>35</sup>. Në janar të po atij viti, gjendjen e vështirë dhe kushtet në të cilat jetonin shqiptarët myslimanë në Greqi, ja raportonte Ministrisë Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Mithat Frashëri, ambasadori shqiptar në Athinë duke vënë theksin tek jetesa e vështirë të shqiptarëve në Greqi, që kishin humbur gjithë pasurinë.<sup>36</sup>

Kryetari i Komisionit Mikst, Ekstrand, i ngarkuar nga Lidhja e Kombeve, përpara se të niste hetimet mbi informacionet që mori për këtë problem, vizitoi Mithat Frashërin, ministrin shqiptar në Athinë, duke e pyetur mbi shpjegimin e fjalës "*origine albanaise*", dhe kërkonte të dinte pse qeverija greke nga ana e saj kërkonte që, përjashtimi të bëhej vetëm për shqiptarët e Epirit dhe jo të Maqedonisë.<sup>37</sup> Mithat Frashëri, me anën e një letre dërguar komisionit Mikst, shpjegonte se nëqoftëse Greqia kishte synim të dëbonte shqiptarët e fesë myslimane, kjo duhej të ishte bërë

<sup>32</sup> AMPJ, Fondi 251, D.203, v.1923, fl.116; B. Blinishti konsull I përgjithshëm në Zvicër I drejtohet Ahmet Zogut, kryetar i këshillit të ministrave, gjenevë 9 gusht 19123; Naska, "Çështja çame në Lidhjen e Kombeve.", 75.

<sup>33</sup> *Dokumenta për Çamërinë ...*, f.140-141; Mithat Frashëri, Ministër Fuqiplotë në Athinë (1923-1926),(përmbledhje me dokumente përgaditi për botim Luan Maltezi dhe Sherif Delvina, Tiranë: Lumo Skëndo, 2002, f.63-65.

<sup>34</sup> *Ethnic Minorities in the Balkan States 1860-1971*, vol. 4..., f.337: Dh. Berati, *Qëllimet dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve*, Tiranë: 1931, f.23: Dh. Berati, *Shënime historike, Mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*, Shtëpia botuese "Husi Borshi", Tiranë: 2007, f.44.

<sup>35</sup> L.Maltezi-Sh. Delvina, *Mithat Frashëri, Ministri fuqiplotë-Athinë 1923-1926*, f.78-79.

<sup>36</sup> L. Malteri- Sh. Delvina, *Mithat Frashëri, Ministri ...*, po aty, f.92.

<sup>37</sup>L. Maltezi- Sh. Delvina, *Mithat Frashëri, ministri ...*, po aty, f.85.



objekt i një marrëveshje midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe jo midis qeverisë greke dhe qeverisë së Ankarasë.

Turqia, nga ana e saj nuk kishte pasur dëshirë të pranojë në vendin e saj refugjatë myslimanë me origjinë shqiptare, ashtu siç ka edhe të drejtë të refuzojë pranimin e një elementi të huaj që do të donin t'ia importonin me forcë<sup>38</sup>. Më 4 prill 1924 në Asamblenë e Madhe Turke, në seancën parlamentare u diskutua për vështirësitë që kishte emigrimi në Anadoll dhe rreziku që sillte ky veprim. Deputeti Xhelal bej (Bayar), deklaronte se, “qytetarë grekë të fesë myslimane” deklarojnë me qëllim që janë turq, por jo çdo mysliman që flet turqisht është turk. Prandaj shpjegonte ai “gabimisht popullsia Çame u lidh me shkëmbimin dhe rreth këtij fakti ata kishin pasur debate ndërmjet tyre”<sup>39</sup>.

M. Frashëri, kishte ndjekur nga afër hetimet e komisionit, duke parë edhe presionin që ushtrohej ndaj fshatrave të Filatit, Ajdonatit, Margëlliçit, i dorëzoi Ekstrandit kryetarit të komisionit Mikst një listë me emra të fshatrave shqiptare para se ai të nisej për inspektim në këto zona. Të njëjtën listë ia kishte dorëzuar edhe ministrit turk në Athinë z. Nebil bej, me emrat e fshatrave shqiptarë të Epirit dhe Maqedonisë për t'ia dhënë delegatit Turk, që do të shoqëronte komisionin.<sup>40</sup>

Në pranverën e vitit 1924, delegati neutral Ekstrandit dhe ai turk Hamdi Beu, ndërmorën një turne në Epir dhe në Maqedoni, konkretisht në Janinë, Prevezë dhe në Selanik, ku në takimet me shqiptarët myslimanë, u kërkua të provonin me dokumenta të shkruara vërtetimin e origjinës shqiptare. Komisionerët nga qyteti i Selanikut iu telegrafuan shqiptarëve të 38 fshatrave me qëllim që ti takonin dhe t'i pyesnin për vërtetësinë e origjinës së tyre. Vetë fshatarët deklaruan se ishin të gjithë me origjinë shqiptare dhe se i takonte Ekstrandit të shkonte nëpër fshatra për ta vërtetuar këtë fakt<sup>41</sup>. Në Maqedoni nënkomisioni Mikst, përbëhej nga delegati grek Floridi, nga delegati Turk Safet Beu dhe baroni Von Linden. Komisionerët ishin të mendimit për ti shpërngulur me dhunë të gjithë shqiptarët e Maqedonisë, ndaj 31 fshatra me shqiptarë të Maqedonisë u larguan. Popullsia u dërgua me grupe të mëdha në Selanik, ku do të niseshin me anije në brigjet e Azisë së Vogël. Vaporët transportonin rreth 7 mijë refugjatë në javë. Kur ata do të mbërrinin në Izmir, apo Stamboll, “mirëpriteshin” me “çaj dhe biskota, fjalime dhe flamuj”, para se të dërgoheshin për në zonat e brendshme të vendit. Qeveria Turke, nëpërmjet zyrtarëve lokalë planifikonte ardhjen e tyre, ju caktonte vendbanimet ku do të vendoseshin dhe, më të varfërve, ju jepte edhe të holla hua.<sup>42</sup> Refugjatët ishin të aq shumtë sa disa prej shqiptarëve që migruan në Anadoll mbetën të pasistemuar për vite të tëra pas mbërritjes së tyre.

Në verë të vitit 1924, procesi i shkëmbimit mori karakter masiv. Më 9 gusht 1924 konsulli shqiptar në Stamboll Nezir Leskoviku njoftonte Ministrinë e Jashtme se, autoritetet turke nuk po i përjashtonin shqiptarët ortodoksë nga shkëmbimi, por po i dëbonin ata së bashku me grekët. Ndaj

<sup>38</sup> Luan Maltezi- Sh. Delvina, *Mithat Frashëri, ministri...*, f.88.

<sup>39</sup> *TBMMZC.*, C.10, s.66.

<sup>40</sup> Luan Maltezi – Sh. Delvina, *Mithat Frashëri, ministri...*, po aty, f.98.

<sup>41</sup> Mehdi Frashëri, *Ekspozaja e Mehdi Frashërit, për çështjen e Çamërisë (në Lidhjen e Kombeve)*, në: Studime Historike, nr.1-4, Tiranë: 1997.

<sup>42</sup> T. Koker dhe L. Keskiner, *Lessons in refugeehood: forced migrants in Turkey*, në botimin e R. Hirschon, *Crossing the Aegean: An Appraisal of the 1923 Compulsory Population Exchange between Greece and Turkey*, Neë York: 2003, f.87; M. Mazoëer, *Selaniku* ..... f.442.

në këto kushte qeveria shqiptare u detyrua që të vendoste si objektiv në veprimtarinë diplomatike të saj, krahas mbrojtjes së popullsisë shqiptare të Çamërisë edhe përpjekjet për të ndarë shqiptarët ortodoksë që jetonin në Turqi nga procesi i shkëmbimit.

Përsëri, konsullata shqiptare në Stamboll telegrafonte se shqiptarët e Greqisë, që ishin dërguar në Turqi si të këmbësorë, për shkak të kushteve të rënda, nuk duan të qëndrojnë atje në asnjë mënyrë dhe i luten qeverisë shqiptare të sigurojë riatdhesimin e tyre<sup>43</sup>.

Pavarësisht veprimeve dhe përçarjeve që bënin shqiptarët, në Prevezë propaganda e Hamdi beut, delegatit turk të komisionit Mikst, vazhdonte të ishte prezente. Ai përpiqej t'u mbushte mendjen klerikëve myslimanë që kishin deklaruar se ishin turq, që të kishin shpresë se myslimanët në Anadoll do të gjejnë të gjitha të mirat dhe ju dhuroi atyre bejannamenë (çertifikatën) që ta mbushnin me të dhënat personale për tu larguar në Turqi.<sup>44</sup> Komisioni Mikst më 14 qershor 1924 u nis për në Stamboll, në Athinë mbeti vetëm kryedelegati turk Tefik Rushdi beu. Mithat Frashëri në bisedimet që zhvilloi me Tefik Rushdi beun, deklaronte se, "kishte instruksione formale nga ana e qeverisë së tij (turke) që të mos përfshiheshin në shkëmbim shqiptarë nga krahina të Greqisë". Tefik Rushdiu premtojte se do ti rekomandonte delegatit turk të Janinës që të merrte një përkthyes shqiptar. Më tej deklaronte se qeveria shqiptare kishte dërguar një note proteste në Ankara, por që unë nuk kam dijeni nga ana ime mbi këtë veprim.<sup>45</sup>

Ekstrandit, përfaqësuesi ndërkombëtar për çështjen e shqiptarëve, kishte dërguar një raport me deklarata të pavërteta Lidhjes së Kombeve, ku mohonte karakterin shqiptar të popullsisë çame. Sipas këtij raporti, theksohej se, "*çamët kanë ardhur nga Manisa e Anadollit ose nga Shami dhe që në shtëpitë e tyre flasin greqisht dhe turqisht, bashkë me një dialekt shqip të formuar nga fjalë greqisht dhe turqisht. Ata nuk i lidh asnjë lloj ndjenje me Shqipërinë, janë turq dhe duan të shkojnë në Turqi.*"<sup>46</sup>

Më 11 gusht 1924, qeveria shqiptare, përsëri nëpërmjet një note proteste drejtuar Këshillit të Lidhjes së Kombeve ju kërkonte ngritjen e çështjes së popullsisë së Çamërisë në një nga seancat e saj. Në letër ankohej se Greqia nuk po e mbante fjalën që kishte dhënë në Lozanë, dhe se popullsia shqiptare e fesë myslimane e vendosur në Greqi do të duhej të përjashtohej nga shkëmbimi i popullsisë greko-turke. Autoritetet greke të krahinës së Çamërisë që përfshin komunat e Filatit, Paramithisë dhe Gumenicës, ku shqiptarët myslimanë janë në masë kompakte, ju komunikuan njoftimin e komisionit Mikst, i cili përmbante dispozitat e shkëmbimit, duke iu kërkuar atyre të qëndronin në gatishmëri<sup>47</sup>. Sipas Dhimitër Beratit popullsia e dëbuar nga viset e Kosturit dhe të Follorinës ishte 33.000 vetë.<sup>48</sup>

<sup>43</sup> *Dokumente për Çamërinë...*, dok 184, f.340. Promemorje mbi këmbimin e popullsisë greko-turke dhe shqiptarët myslimanë dërguar nga Sulejman Delvina Ministër i Punëve të Jashtme..

<sup>44</sup> L.Maltezi-Sh. Delvina, *Mithat Frashëri...*, f.103

<sup>45</sup> L.Maltezi-Sh. Delvina, *Mithat Frashëri...*, f.103

<sup>46</sup> L.Maltezi-Sh. Delvina, *Mithat Frashëri...*, f.115.

<sup>47</sup> *AQSH*, F.151, viti 1924, Dosja 84.

<sup>48</sup> Dh. Berati, *Shënime historike...*, f.45

Prandaj qeveria shqiptare e autorizoi Benoit Blinishtin të ndërhynte pranë Lidhjes së Kombeve për të përjashtuar nga shkëmbimi të gjithë ortodoksët shqiptarë të Turqisë<sup>49</sup>.

Më 21 korrik 1924, Ministri i Jashtëm Sulejman Delvina e njoftonte kryeministrin shqiptar Fan Noli se: “Qeveria greke, megjithëse ka marrë vendime zyrtare për të mos shkëmbyer myslimanët shqiptarë, nuk i ka respektuar kurrësi këto zotime. Autoritetet greke po bëjnë një propagandë të rreptë për të shtrënguar shqiptarët të emigrojnë në Anadoll. Duke parë nga qeveria greke këtë mungesë sinjeriteti, do të vazhdonte Sulejman Delvina, këtë çështje, ne ia parashtruam Këshillit të Lidhjes së Kombeve, i cili ripohoi edhe një herë vendimin që elementi shqiptar në asnjë mënyrë të mos dërgohet në Turqi duke i dhënë udhëzime të prera edhe Komisionit Miks. Nga ana tjetër, kemi zhvilluar disa herë përçapje edhe pranë qeverisë turke, që ajo të mos i pranonte shqiptarët e Greqisë në shkëmbim.”<sup>50</sup>

Në shtator 1924, përsëri Sulejman Delvina Ministri i Jashtëm, i dërgonte një telegram Ministrin të Jashtëm të qeverisë turke Ismet Pashës, ku e informonte se qeveria shqiptare do të dërgonte Mithat Frashërin ministrin e Shqipërisë në Athinë me mision të posaçëm pranë Qeverisë Turke<sup>51</sup>. Për të mbështetur fushatën diplomatike të qeverisë shqiptare, gjatë qëndrimit të tij në Stamboll, Mithat Frashëri u takua edhe me zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Turqisë, me kryedelegatin Tefik Rüştü Arasin, por edhe me Mithat Beun, delegatin në komisionin e Epirit, kryetarin e komisionit Mikst, gjeneral De Lara dhe përfaqësues të tjerë.

Konsulli shqiptar në Stamboll, Nezir Leskoviku takoi Tefik Rushdi beun kryedelegatin Turk në komisionin Mikst, të cilin e kishte pyetur në lidhje me masat e marra nga qeveria Turke për përjashtimin e çamëve nga ky shkëmbim. Ai kishte deklaruar se, “*vendimi i Ankarasë është zyrtar dhe se përjashtimi i çamëve komplikohet me shkëmbimin e ortodoksëve të Stambollit*”<sup>52</sup>.

Kështu qeveria Turke i’u kishte kërkuar nëpunësve të saj të merrnin masa paraprake, që gjatë shkëmbimit shqiptarët ortodoksë të përjashtoheshin nga ky veprim<sup>53</sup>.

Më 8 nëntor 1924, Ismet Pasha Ministri i Jashtëm turk i dorëzoi një notë proteste Lidhjes Kombeve, në lidhje me “qëndrimin, sjelljen dhe dhunën që përdornin grekët kundër popullsisë msylimane gjatë shkëmbimit<sup>54</sup>. Të njëjtin veprim e kreu edhe qeveria greke lidhur me qëndrimin e qeverisë Turke ndaj popullsisë ortodokse të Anadollit.

Më 10 dhjetor të 1924, kryeministri Fan S. Noli, i kishte dërguar një letër kryetarit të qeverisë turke të asaj kohe Fethi Beut (Okyari), të cilit i kërkonte që nga ana e qeverisë së tij të bëjë një deklaratë zyrtare në lidhje me shkëmbimin e popullsisë. Në letër kërkohej ti jepej një zgjidhje sa më e shpejtë dhe përfundimtare kësaj çështje në përputhje me rregullat e drejtësisë dhe me interesat e Shqipërisë<sup>55</sup>.

<sup>49</sup> AMPJ, D.85, V.1924, fl.136, Letër e Ministrin të Punëve të jashtme Sulejman Delvina për Ministrin shqiptar në Athinë Mit’hat Farshëri 20.8.1924.

<sup>50</sup> *Dokumente për Çamërinë...*, Dok. 170, f. 315 –316. Sulejman Delvina, ministër i Punëve të Jashtme në Tiranë, 21 korrik 1924

<sup>51</sup> AMPJ, F. 151, D.83, v.1924, f.195, Tiranë më 26 shtator, Shkëlqesisë së tij Ismet pasha, President i Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Ankara.

<sup>52</sup> AMPJ, D.83, v.1924, fl.87, Stamboll 20 shtator 1924.

<sup>53</sup> BCA, Fon Kodu 272 0011, Sira no 9, Dosya gómleği 68.

<sup>54</sup> AMPJ, F.151, D.97, v.1923, League of Nations.

<sup>55</sup> AMPJ, F.151, D.82, v.1924, f.162: *Dokumente për Çamërinë...*, f.398.

Përsëri Mehdi Frashëri, përfaqësuesi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve u takua me ambasadorin e Turqisë pranë Lidhjes së Kombeve dhe i kërkoi bënte një deklaratë lidhur me këtë problem<sup>56</sup>. Përfaqësuesi Turk ju përgjigj se ai po priste përgjigjen zyrtare të Ankarasë. Sipas Mithat Frashërit fillimisht kur Ankaraja shpresonte të triumfonte pikëpamja e saj për dëbimin e gjithë ortodoksëve delegati turk kishte kërkuar që Shqipëria të mos ngulte këmbë për ndalimin e largimit të ortodoksëve shqiptarë dhe këtë e kërkonte si kompensim për mospranimin e Çamëve në Anadoll nga qeveria Turke. Por pasi u vendos që gati 140.000 grekë me banim në Stamboll qysh para vitit 1918, do të mbeteshin në këtë vend me ta mbeteshin edhe shqiptarët ortodoksë. Në këtë situatë, autoritetet turke treguan se favorizuan qëndrimin e shqiptarëve dhe do t'u vinte më mirë për ta të qëdnronin si shqiptarë se sa si grekë.

Mithat Frashëri, në një letër dërguar Mehdi Frashërit, përfaqësuesit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, kërkonte që të mos prekesh problemi i ortodoksëve shqiptarë në sesionet e Lidhjes, sepse sic shprehej ai, ortodoksët shqiptarë qeveria turke nuk do t'i trazonte dhe as nuk t'i dëbonte.<sup>57</sup> E gjitha kjo bëhej në kuadër të triumfit të tezës turke “*établie*”.<sup>58</sup>

Turqia kërkonte që Shqipëria, çështjen e të krishterëve të saj të mos ta bënte problem në sesionet e Lidhjes së Kombeve, dhe heshtja e shqiptarëve do të përdorej, që këta të mos pranonin çamët në Anadoll. Në dokumentat arkivës turke për këtë problem në një dokumnet drejtuar komisionit Miks, ishte nënvizuar: “...*ju vëmë në dijeni që sipas traditës turke, ortodoksit shqiptarë nuk janë të shkëmbyeshëm.*”<sup>59</sup>

Përpjekjet diplomatike të përfaqësuesve për çështjen e shkëmbimit të popullsisë tërhuqën vëmendjen e përfaqësuesit të Spanjës, Quinones De Leon që i raportonte Këshillit të Lidhjes për çështjen e shqiptarëve të Greqisë. Ai deklaronte se ishte i bindur që në dëm të minoritetit shqiptar të Greqisë, po kryhej një shpërdorim i madh, dhe propozonte se duhej të kishte një bashkëpunim më të afërt mes Komisionit Miks dhe organeve të Lidhjes së Kombeve, duke kryer një hetim të paanshëm, dhe kërkoi të emëroheshin anëtarë asnjënjë pranë Komisionit ku secili prej tyre, të kishte përkthyes një person me prejardhje shqiptare të zgjedhur nga ata vetë<sup>60</sup>. Më 13 dhjetor 1924, u hartua gjithashtu një rezolutë dhe u ngrit një komision i ri, Komisioni i Mandatimit me kryetar Z. Ajnar Ekstrand (Suedi). Pranë tij u ngritën edhe dy nënkomisone të reja në Epir dhe Maqedoni, ku u ngarkuan ekspertë shqiptarë si këshillues dhe si përkthyes të zgjedhur nga ata vetë. Ky komision do të ishte tashmë një instrument në duart e Këshillit të Lidhjes, me qëllim, “*mbrojtjen e pakicave shqiptare në Greqi*”<sup>61</sup>.

Nga Stambolli Mithat Frashëri njoftonte se kishte 3 muaj që Këshilli i Ministrave në Ankara (Angora) vendosi të mos pranojë asnjë person nga Çamëria, meqenëse popullsia e atij vendi është shqiptare. Ky vendim u konfirmua zyrtarisht edhe nga Tefik Rushdiu në Komision Miks. Pas nisjes

<sup>56</sup> AMPJ, F.151, D.82, v.1924, fl.172-173.

<sup>57</sup> AQSH, Fondi 251, viti 1924, f.299. Letër dërguar delegatit të Shqipërisë pranë Lidhjes së Kombeve.

<sup>58</sup> *Établi*- vjen nga frengjishtja dhe në gjuhën turke do të thotë *yerleşmiş*, ndërsa në gjuhën shqipe -vendosje, stabilizim.

<sup>59</sup> *Başbakanlık Cumhuriyet Arşivine* (B.C.A), (Arkiva e Kryeministrisë së Republikës), Fon Kodu 2720012, Kutu no. 43, Dosya Gomlegi no. 62.

<sup>60</sup> AMPJ, F.151, V.1924, Dos.84, fl.168-172. Informacioni i Legatës shqiptare në Athinë për Ministrinë e Punëve të jashtme, 25 maj 1924.

<sup>61</sup> AMPJ, V.1924, dos.84, fl.168-172. Informacion I Legatës shqiptare në Athinë për Ministrinë e Punëve të jashtme, 25 maj 1924.

në Romë të Tevfik Rushdiut, ne u takuam përsëri me delegatin turk Mithat Beun në nënkomisionin e Epirit, i cili na rikonfirmoi vendimin e marrë në Ankara (Angora). Ky vendim u komunikua prej Ankarasë nëpërmjet përfaqësuesve të saj pranë Komisionit Mikst dhe kjo ishte e mjaftueshme. Sipas Mithat beut, delegati turk në Komisionin Miks, deklaronte se vetëm në “Çamëri kishte afro 1.000 persona në Pargë dhe Paramithi, të cilët kishin marrë bejanname (çertifikatën) për këmbim. Një pjesë e tyre i kishte mbaruar të gjithë formalitetet dhe pritej të vinte një vapor për ti transportuar për në Stamboll.”<sup>62</sup>.

Krahas tij edhe Eëidding drejtuesi i komisionit Mikst kishte treguar një telegram ku një komison nga Çamëria që kishin marrë *bejannamen*, i lutnin komisionerët që ti dërgonin një orë e më parë në Anadoll. Më pas përfaqësuesi turk Mithat Beu, ishte shprehur se, ata që kanë për të ikur nga Parga dhe Paramithia ishin me origjinë prej Moresë, Lalotë<sup>63</sup>. Në raportet e hartuara nga komisioni Miks i bëri nëpunësit që të shqyrtonin çështjen e shqiptarëve myslimanë të krahinës së Janinës në Çamëri<sup>64</sup>.

Më 25 nëntor 1924, Mithat Frashëri në një letër dërguar nga Stambolli, do të jepte një përshkrim të hollësishëm mbi shqiptarët ortodoksë që jetonin dhe punonin në atë qytet. Në këtë letër, ai theksonte se: “pjesa më e madhe e tyre nuk ishte e regjistruar, nuk kishte dokumenta të lëshuara nga konsullata shqiptare por as nga Komiteti i Kolonisë së Stambollit të “*Shoqërisë Shqiptare të Ndhmës*”. Njëkohësisht ato nuk kishin *nyfyse* (letërnjoftime) të lëshuara nga Turqia, as dokumenta nga amza e gjendjes civile, apo nga regjistrat e kishave në Shqipëri. Kishte edhe persona të tjerë, që s’kishin asnjë dokument zyrtar dhe që po përpiqeshin ti merrnin”<sup>65</sup>.

Në një raport për Ministrinë e Jashtme, ai shkruante se ortodoksët shqiptarë të Stambollit ishin përafërsisht 10.000 veta<sup>66</sup>dhe se ata zotëronin një kapital praj disa milion franga ari. Prej këtyre vetëm 800 persona kishin marrë certifikatë nënshtetësie dhe të tjerët nuk kishin asnjë dokument identifikimi por përpiqeshin ti merrnin tani kur Turqia po i konsideronte si grekë<sup>67</sup>.

Meqenëse deri në këto momente komisioni Miks ishte shprehur dhe e kishte çuar çështjen e tyre në Komisionin e juristëve, deri në marrjen e një vendimi nga ky i fundit, shqiptarët ortodoksë në lagjet e Stambollit nuk do prekeshin. Nisur nga ky lëshim që po ju bëhej për momentin kësaj pakice, konsulli shqiptar kishte folur edhe zyrtarin e Ministrisë së Punëve të Jashtme duke u munduar ta bindë se gjendja e një pakice ortodokse shqiptare midis grekëve në Stamboll do të ishte në favor të turqve. Sepse sipas tij kjo do të dobësonte intrigat e patrikanës greke, meqenëse

<sup>62</sup> AMPJ, F.251, v.1924, d.212, fl.72-73. Mithat Frashëri i drejtohet Ministrisë së punëve të jashtme, Tiranë. Pera, 15dhjetor 1924.

<sup>63</sup> Nuk e dinte që Lalotë dhe Burodnotët qenë shqiptarë nga të Moresë, të kthyerë në Besë Muhamedane. AMPJ, V.1924, d.212.f.72-73. Letër Mithat Frashërit dërguar Ministrisë së Punëve të jashtme Tiranë, Pera, 15 dhjetor 1924. Të dhëna për shqiptarët ortodoksë në Stamboll. L.Maltezi & Sh. Delvina, *Mithat Frashëri...*, f.145.

<sup>64</sup> BCA, Fon Kodu 2720011, Sira no,19, Dosya gōmleği 92.

<sup>65</sup> AMPJ, viti 1924, dos.301, fl.48-49. Shqipatrët ortodoksë në Stamboll, nga Mithat Frashëri. Pera 25 nëntor 1924.

<sup>66</sup> Shqiptarët, myslymanë e të krishterë të vendosur në Stamboll, llogariten të paktën nga 15 gjer 20 mijë. Në këtë numër nuk përmbahen natyrisht ata të 50-60 mijë shqiptarëve shkruante, -Branko Merxhani që u vendosën përfundimisht në Stamboll dhe në viset e tjera të Turqisë dhe të cilët, sidomos nga shkak i lidhjeve fetare, u përthitën krejt nga Turqizma dhe kanë zënë pozita me rëndësi që nga pozita e lartë e ministrit gjer në katedrat e nderuara të Univeritetit të Stambollit. shih. Branko Merxhani, *Vepra...*f.126.

<sup>67</sup> AMPJ, D.85, v.1924, fl.279, Letër e Ministrit shqiptar Midhat Farshërit nga Stambolli, për Ministrin e punëve të Jashtme, Sulejman Delvina. 25.11.1924.

shqiptarët kishin nisur të ngrenë kishën e tyre<sup>68</sup>. Kjo kishë shqiptare theksonte ai mund të ndërtohej sipas modelit të kishës së kolonisë rumune në Stamboll e cil ishte krejt e shkëputur nga helenizmi<sup>69</sup>. Në gjysmën e parë të dhjetorit 1924, disa ortodoksë shqiptarë të kolonisë së Stambollit, themeluan një kishë ortodokse shqiptare. Njëpëmjet saj ata përpiqeshin të bindnin qeverinë turke, se nuk kishin asnjë lidhje shpirtërore me Greqinë dhe se kishin një origjinë dhe etni të ndryshme nga grekët. Pavarësisht kërkesave dhe presionit të qeverisë shqiptare ndaj asaj turke që nga viti 1923 deri më 14 qershor 1931, për gati nëntë vjet qeveria Turke nuk u kujdes të rregullojë pozitat e këtyre njerëzve. Kjo anomali kaq e gjatë rrodhi nga shkak i mosbesimit të autoriteteve turke ndaj tyre dhe, sidomos nga taktika spekulative e delegacionit grek pranë komisionit Miks të shkëmbimit të popullsisë. Pas nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë Turko-Greke, të nënshkruar më 10 qershor të vitit 1931, u zgjidhën përfundimisht të gjitha çështjet që lindën nga zbatimi i akteve të nxjerra nga shkëmbimi i popullsisë turko-greke, parashikuar në artikujt e Traktatit të Lozanës. Kështu u zgjidh edhe çështja e popullsisë ortodokse shqiptare që kishte ardhur në Turqi nga ish-krahinat e Perandorisë Osmane:

Së pari, ata do të quhen “*etabli*” (të vendosur) sipas kuptimit të kreut 5 të traktatit turko-grek dhe kështu do t’ju lëshoheshin çertifikatat sipas artikullit 10 të po këtij traktati. Po të kenë pasuri të tundshme apo të patundshme, të ndodhura jashtë zonës së përjashtuar të shkëmbimit, këto pasuri sipas artikullit 12, do të bëheshin mall i Qeverisë Turke dhe pronarët do të shpërbleheshin sipas artikullit 20 ku sekuestrot e vëna do të ngriheshin menjëherë.

Së dyti, personat në fjalë do të quheshin, sikur nuk kanë asnjë lidhje me Konventën e shkëmbimit dhe me dispozitat e veçanta që rrjedhin prej saj. Pavarësisht se ishin nënshtetas turq të përjashtuar nga shkëmbimi, vetëm sepse ishin të fesë ortodokse u bënë mollë shërri në komisionin Miks pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Ankarasë dhe kërkesës nga pala greke. Delegacioni grek përkrahte tezën e parë, ndërsa ai turk tezën e dytë. Debati ndërmjet tyre, lidhur me këto teza i ndihmoi shumë nga pikëpamja e origjinës dhe pavarësisë fetare shqiptarët ortodoksë, të vendosur në Stamboll. Duke parë gjendjen që u krijua më 14 qershor 1931 u dha vendimi arbitral i anëtarëve neutral të komisionit Miks për mos shpërnguljen dhe shkëmbimin e popullsisë ortodokse shqiptare. Ky vendim përmbante një përshkrim historik të plotë dhe interpretim ndërkombëtar të çështjes, duke i lidhur shqiptarët ortodoksë të Stambollit me kishën autoqefale shqiptare e cila ishte pjesë e kishave ortodokse kombëtare të tjera.

Me rritjen e lutjeve dhe kërkesave nga pala shqiptare, me ndryshimin të kursit të jashtëm politik të saj, Turqia do të ndryshonte qëndrimin, duke vendosur si kusht përcaktimin dhe zbatimin e kritereve për popullsinë e shkëmbyeshme.

Lidhur me procesin e shkëmbimit historiografia turke jep shifra të ndryshme.

Sipas censusit të parë të regjistrimit të popullsisë të bërë në vitin 1927, në Turqi ishin vendosur 21.774 persona që flisnin shqip në qytetet e Stambollit, Izmirit dhe Bursës<sup>70</sup>. Ndërsa nga të dhënat

<sup>68</sup> AMPJ, D.301, v.1924, fl.48-49. Shqiptarët Ortodoksë në Stamboll.

<sup>69</sup> *Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX*, vëll. II, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2019, f. 566.

<sup>70</sup> Nurcan Özgür Baklacioğlu, *Albanian Migrations and the problem of security in the Balkans*, botuar në Turkish Review of Balkan Studies, Annual 2001, nr. 6, f.83.

zyrtare të censusit të vitit 1935, rezultojnë rreth 40.657 shqiptarë 50 % më tepër se në vitin 1927<sup>71</sup>. Kjo tregon që shifrat mund të ndryshonin në varësi të të dhënave, regjistrimeve të bëra, rrugës së ndjekur dhe mbi ç'kritere janë zhvilluar ato. Ajo ç'ka mbetet e pa ndryshuar dhe e vërtetë është fakti se, popullsia shqiptare ishte ajo, që pagoi koston e këtij shkëmbimit dhe rrjedhojat e tij për dekada të tëra, pasoja të cilat vazhdojnë edhe sot.

Duke ju referuar historiografisë shqiptare, konkludojmë se: gjatë gjithë periudhës së realizimit të marrëveshjes së Lozanës, procesit të shkëmbimit të detyrueshëm të popullsisë nga trojet amtare u përzunë me dhunë 60 000 shqiptarë (40. 000 nga viset e Maqedonisë greke dhe 20. 000 nga krahina e Epirit).<sup>72</sup>

### **Konkluzione**

Si përfundim mund të themi se: Më 23 korrik 1923, në Lozanë u firmos një Traktat ndërkombëtar midis qeverisë turke dhe shteteve fituese të Luftës parë Botërore. Kjo marrëveshje, që njihet si Traktati i Lozanës, ishte ngjarja më e rëndësishme diplomatike e epokës qemaliste, e cila do të vendoste themelet e Turqisë së re dhe të ardhmes së saj. Nënshkrimi i traktatit të Lozanës detyroi fuqitë e mëdha dhe Greqinë të pranonin pavarësinë e plotë të Turqisë, dhe vendosi që trupat e huaja ushtarake duhet të largoheshin nga Turqia përpara datës 2 tetor 1923. Ky vendim do të përcaktonte njohjen *de facto* dhe *de jure* të shtetit turk nga fuqitë perëndimore.

Shkëmbimi i popullsisë i realizuar pas nënshkrimit të *Konventës Greko-Turke të 30 janarit 1923*, nga dy figurat politike të asaj kohe Mustafa Qemal Ataturku dhe Elefteros Venizelos, - sipas studuesve perëndimorë, *të përbashkët kishin perspektivën nacionaliste të vendeve të tyre. Shkëmbimi i popullsisë i ndihmoi ata në krijimin e komb-shteteve me etni homogjenike të pastra.*<sup>73</sup>

Ndërsa përse i përket marrëdhënieve shqiptaro-turke shkëmbimi pati këto ndikime: *Së pari* në këtë traktat, shqiptarët nuk ishin palë e nënshkrimit të tij, por u përdorën si elemente në shkëmbimin e popullsisë. *Së dyti*, traktati plotësoi vetëm dëshirat e dy shteteve ballkanike, të cilët nëpërmjet tij arritën të krijonin homogjenizimin e popullsisë dhe krijuan shtete të pastra nacionaliste, si dhe rritën ekonominë e tyre. *Së treti*, Traktati i Lozanës e dhunoi ashpër popullsinë shqiptare të krahinës së Çamërisë, duke e shkatërruar e dëmtuar me pasoja të rënda, të cilin popullsia e asaj krahine vazhdon ta vuajë edhe sot.

---

<sup>71</sup> Në vitin 1935 thuhet që numri i popullsisë që flet shqip si gjuhë kombëtare ishte 14.496 ndërsa i personave që e flasin shqipen si një gjuhë të dytë është 26.161. Po kështu besimi i emigrantëve është 12.5% të shqiptarëve ishte kristianë. Ata që flasin si gjuhë amtare shqipen janë nga qytetet, ndërsa ata që e flasin si gjuhë të dytë janë banorë të zonave rurale. Fuat Dünder, *Türkiye, Nüfus Sayımların Azınlıklar*, Döz Yayınları, İstanbul: 1999, f.24-25.

<sup>72</sup> B. Meta, *Kosova dhe Çamëria në gjysmën e parë të shekullit XX-një vështrim krahasues*, Studime Historike, 2005, nr.3-4, f.60.

<sup>73</sup> M.Mazower, *Ballkani një histori e shkurtër*, Skënderbeg books, Tiranë: 2010, f.132.

## **BIBLIOGRAFI**

### **Burime arkivore**

Arkivi Qendror Shqiptar, Fondi 251.

Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme Shqiptare , Fo.151.

Başbakanlık Cumhuriyet Arşivine (Arkiva e Republikës Turke).

### **Botime dokumentare**

*Atatürk ve Türkiye Cumhuriyeti Tarihi*, Besinci Baski, Siyasal Kitabevi, Istanbul: 2004.

*Dokumenta për Çamërinë 1912-1939*, (Përgatiti për botim Kaliopi Naska. Tiranë: Dituria, 1999.

*Mithat Frashëri, Ministër Fuqplotë në Athinë (1923-1926)*, (Përmbledhje me dokumente përgatiti për botim Luan Maltezi dhe Sherif Delvina), Tiranë: Lumo Skëndo, 2002.

*Ethnic Minorities in the Balkan States 1860-1971*, c. 4. (1923-1926), (Editor B. Destani), Published Archives, London: 2008..

*Convention Concerning the Exchange of Greek and Turkish Populations*, Treaty series 32, v. 1925.

*Türk İstiklal Harbi, (TIH)*, C. 2, Kitap 4, Genel Kurmay Atase Yay.: Ankara; 1994.

### **SHTYPI**

*Açıksöz*, 3 Ekim 1923.

*Fletorja Zyrtare*, 9 Shtator 1923:

“*Shqipëria e re*” (*Novia Albania*), 7 janar, no. 112, s. 1:

### **Artikuj dhe Monografi**

AGANOĞLU, Y. H. *Osmanli'dan Cumhuriyete Balkanların Makus Talihi: Goç*, İz Yayıncılık, 7 Baski, Istanbul: 2012.

AKALIN, Hakki. “*Ege*”de Bahar, *Gül mü Diken Mi!* Umit Yayıncılık, Ankara: 2000.

ARI, Kemal. *Büyük Mübadele, Türki'ye Zorunlu Göç (1923-1925)*, Istanbul: 1995.

BAKLACIOĞLU, Nurcan Özgür. *Albanian Migrations and the problem of security in the Balkans*, Turkish Review of Balkan Studies, Annual 2001, nr. 6, s.83.

BERATI, Dhimitër. *Qëllimet dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve*, Tiranë: 1931.

BERATI, Dhimitër. *Shënime historike mbi Marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*, Tiranë: “Husi Borshi”, 2007.

ÇELEBI, Ercan. *Mübadillere Yunanistan'daki Mal Kayıtları ve Muhtelit Mübadele Komisyonu Tasfiye taleplerleri*, ÇITTAD, V/12, (2006/ Bahar), s. 35-36.

DÜNDAR, Fuat. *Türkiye, Nüfus Sayımların Azınlıklar*, Döz Yayınları, Istanbul: 1999.

ISUFI, Hajredin. *Çamëria, studime historike-sociologjike Shek. XIII-XX*, Pegi, Tiranë: 2006.

ISUFI, Hajredin. *Politika e shtetit grek për dëbimin e popullsisë Çame*, Studime Historike, no. 1-4, Tiranë: 1993, s.61.



- ISUFI, HAJREDIN. *Çamëria ndërmjet kronikave të kohës 1902-1940*, Pegi, Tiranë: 2007.
- FRASHËRI, Mehdi. *Ekspozeja e Mehdi Frashërit, për çështjen e Çamërisë (në Lidhjen e Kombeve)*, (çev. Nestor Nepravishta), Studime Historike, nr.1-4, Tiranë: 1997, s.195.
- FRASHËRI, Mehdi. *Kujtime (Vitet 1913-1933)*, Tiranë: OMSCA-1, 2005.
- Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III, (Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912-7 Prill 1939), Tiranë: Botimet Toena, 2007.
- Historia e Shqiptarëve gjatë shek. XX*, Vëll. II, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2019.
- MAZOWER, Mark. *Ballkani një histori e shkurtër*, Tiranë: Skënderbeg books, 2010, f.132.
- MERXHANI, Branko *Vepra...*f.126.
- META, Beqir. *Kosova dhe Çamëria në gjysmën e parë të shekullit XX-një vështrim krahasues*, Studime Historike, 2005, nr.3-4, f.60.
- META, Beqir *Tragjedia Çame*, Instituti i Studimeve për Çamërinë, Tiranë: Botimet Klean, 2010.
- MINGA, Hasan. *Marrëveshja e Lozanës*, nënshkruar më 30.01.1923, Artikulli i I, paragrafi i parë. Bkz. "Çamëria" Nr. 7 (26), Viti II- të, 8 maj 1992, s. 3-4.
- ÖKSÜZ, Hikmet. *Balkan Ülkelerdin'den Türkiye'ye göç sonrası iskan meselesi (1923-1938)*, VII, Milletler Arasi, Türkoloji Kongresi, Istanbul: 1999, s. 173.
- PEARSON, Owen. *Albania and King Zog (Indipendence, Republic and Monarchy 1908-1939)*, The centre for Albanian Studies, London: 2004.
- PEKER, Mumtaz. *Lozan Konferansın'da Nüfus Tartışmaları*, Belleten C. LXIX, Sayı 256, Ankara: 2005, s. 1021.
- RAMA, Fatmira. *Problemi Çam në Lidhjen e Kombeve (1923-1926)*, Studime Historike, no. 1-2, Tiranë: 2007, s. 112.
- RAMA, Fatmira. *Traktati i Lozanës, shpërnguljet dhe shpronësimi (1923-1926)*, në "Çështja Çame dhe Integrimi Evropian", Instituti i Studimeve për Çamërinë, Fakultetit i Histori-Filologjisë, Arbëria, Tiranë: 2005, s. 42.
- KÖKER Tolga and KESKINER, Leyla. "Lessons in Refugeehood: The experience of Forced Migrants in Turkey" in Renée Hirschon (ed.), *Crossing the Aegean: An Appraisal of the 1923 Compulsory Population Exchange Between Greece and Turkey*, 2003.